



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



02 Nr. 060/04-9038 dt. 28/02 2022

## PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 16.02.2022, ora 10:00.

Mbledhjen ë kryesoi: Milaim Hajdari- Kryesues

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, si dhe drejtor të drejtorive komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

### Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 19. 01.2022.
2. Propozim Vendim për vazhdimin e vlefshmërisë së Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për vitin 2022.
3. Propozim Vendim për shfuqizimin e pikës 13, të nenit 1 të Vendimit Nr. 12-360-68569, të dt. 29.11. 2019, të Kuvendit Komunal të Drenasit.
4. Propozim Vendim për formimin e komisionit për çështjet e banimit social.
5. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr. 12-462/01-4122, të dt. 26.01.2022.
6. Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për zbatimin e Aktgjykimit C. nr. 97/86, të datës 06.10.1988
7. Të ndryshme.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës, pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan në mënyrë unanime.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: **1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa i mbajtur më dt. 19.01.2022.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me:

07 vota (Për), kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**-hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës. **2. Propozim Vendim për vazhdimin e vlefshmërisë së Planit Komunal të Menaxhimit të Mbeturinave për vitin 2022.**

**Arbër Halilaj**, kërkoj nga drejtoresha një sqarim meqë thuhet vazhdimin e vlefshmërisë, a nënkupton kjo që ka me u përpiluar një plan i ri në të ardhmen edhe kur? Meqë po kërkohet vazhdimi i vlefshmërisë të planit ekzistues.

**Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krap**i - në bazë të dispozitave të nenit 12 paragrafi 12.2 të ligjit për vetëqeverisje lokale, neni 10 paragrafi 2 ligji për mbeturina, dhe vendimit të Kuvendit Komunal me nr. 12-5/01-13817 i dt. 16.03.2016 është miratuar plani për menaxhimin e mbeturinave nga Kuvendi i Komunës së Drenasit. Për çdo vit Ministria e planifikimit hapësinor i hap grandet ku gjitha komunat e kanë të drejtën me raportu me sistemin e menaxhimit të mbeturinave, njeri prej indikatorëve kërkohet edhe plani komunal për menaxhimin e mbeturinave, komuna e ka të hartuar planin 2016-2020, por për shkak se ne e kemi formuar grupin punues pas çdo viti duhet të bëhet vazhdimi i vlefshmërisë, meqenëse Ministria e planifikimit hapësinor dhe Gizi kanë hapur një konsulentë ku donë me e bërë planin e menaxhimit të mbeturinave për të gjitha komunat bashkërisht, dhe neve për mos me na ik ky indikator kemi kërkuar që me edhe vazhdimin e vlefshmërisë për vitin 2022, meqenëse raportimi behet me 31 mars ne duhet me pas këtë vlefshmëri që mos me humb këtë pikë të indikatorit.

**Azemine Gjoka** - është një shqetësim i madh nga qytetaret e Komunës së Drenasit, çështja e pastrimit dhe grumbullimit të mbeturinave, kërkojmë sqarim nga drejtoria kompetente se cili është plani i veprimit për këtë çështja me rendësi pasi që mbeturinat e grumbulluara në kontejnerët paraqesin rrezik për banoret e fshatit pasi që edhe qentë endacak po i riciklojnë ato mbeturina. Cili është plani i veprimit të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2022. Grandet që i keni fituar prej 1 milion euro ku i keni shfrytëzuar a i keni shfrytëzuar apo ende jo dhe për çka?

**Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krap**i – sa i përket kësaj pike dhe diskutimit që e pate janë dy pika të ndryshme, sepse grumbullimi i mbeturinave behet në nivel regional ne vetëm e mbështetim kompaninë dhe i krijojmë kushte që ajo me vepru, sipas tyre makineritë e vjetra nuk janë në gjendje që me operua, ne si komunë gjithnjë me këto grande që po i ftojmë e mbështetim kompaninë asete për kompaninë, një kamion e kemi në procedura të prokurimit për grandin që e kemi fituar për vitin 2016. Çështja e grandit ka të bëjë me nivelin regional nuk ka të bëjë me neve, ne vetëm e mbështetim i krijojmë kushte

kompanisë që ajo me mujt me operu më lehtë. Ajo çka ne po mendojmë për të bërë në të ardhmen, me e bërë kompani komunale që komuna me pas qasje.

**Azemine Gjoka**, në hartimin e planit a i keni paraqit vështirësitë që i ka kompania e pastrimit për vitin 2022?

**Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krap**i - paraprakisht në planin e menaxhimit të mbeturinave, në planin komunal janë të specifikuara në bazë të planit të menaxhimit të mbeturinave në nivel të Kosovës, ne nuk mundemi me bërë plan ë posaçëm mirëpo të rekomandimet mundemi me rekomandu që komuna ka të drejt me bërë kompani komunale dhe në momentin që të behet kjo kompani ne kemi të drejtën që gjitha shqetësimet ti adresojmë në nivel komunal .

**Arbër Halilaj**, duhet me u vazhdua një plan ekzistues derisa nuk behet një plan i ri derisa nuk është i harmonizuar dhe vlen për të gjitha komunat, mirëpo duke pas parasysh çdo komunë i ka specifikat e veta. Mendoj që jemi në një pikë të përbashkët që zgjidhja do të është me inicua themelimin e kompanisë publike komunale dhe një drejtori për çështje mjedisore mendoj që do ta lehtësonte punën e drejtorisë tuaj.

**Hamit Haxhiu**, nëse nuk vazhdohet ky plan çfarë kushte i keni ofruar ju ministrisë të planifikimit hapësinor? Njëkohësisht kërkoj këta dy mujt e fundit taksapaguesit të lirohen pasi që nuk është bërë grumbullimi i mbeturinave, a ka mundësi me u lirua nga pagesa për muajin janar shkurt të paktën?

**Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krap**i - sa i përket çështjes së parë të ngritur mundet mos me u vazhdu mirëpo hiqen piket.

**Arbër Halilaj**, vazhdimi i planit është i domosdoshëm qoftë i mirë apo jo derisa të përpilohet plani për të gjitha komunat njësoj, dhe me insistua që komuna me pas kompaninë e vet publike komunale për menaxhimin e mbeturinave.

Pasi që nuk pati diskutime tjera e rekomanduan këtë pikë të rendit të ditës për kuvend, kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: **07 vota (Për)**, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: **3. Propozim Vendim për shfuqizimin e pikës 13, të nenit 1 të Vendimit Nr. 12-360-68569, të dt. 29.11. 2019, të Kuvendit Komunal të Drenasit.**

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime e rekomanduan këtë pikë të rendit të ditës për kuvend, kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: **07 vota (Për)**, kundër nuk pati, abstenim nuk pati.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**- hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për formimin e komisionit për çështjet e banimit social.**

**Drejtori i Shëndetësisë Arsim Haxhiu**, edhe kjo ndërlihet me çështjet e banimit social, respektivisht me programin e përkohshëm social që e kemi bazuar ne ligjin 03/L-164 regjistraturën e kaluar kanë shkuar, tani me janë bërë ndryshimet, kanë qenë të përfshirë tre

anëtar të kuvendit 3 anëtar nga ekzekutivi edhe një anëtar nga shoqëria civile, meqë kontratat e banimit social janë të përkohshëm dy vjeçare skadojnë diku fund muajit qershor- korrik komisioni duhet të formohet me anëtar të rinj sepse duhet të përfundojnë procedurat, behet shpallja publike, aplikojnë shfrytëzuesit dhe komisioni vlerëson.

Pasi që nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime në mënyrë unanime të gjithë anëtarët e KPF-së e rekomanduan këtë pikë të rendit të ditës për kuvend.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari-** hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Propozim Vendim për shfuqizimin e Vendimit Nr. 12-462/01-4122, të dt. 26.01.2022.**

Anëtarët e KPF-së kërkuar sqarim rreth kësaj pikë të rendit të ditës, kryesuesi e dha sqarimin, ky vendim shfuqizohet për arsyeje sepse duhet të formohet komisioni për secilën pronë veç e veç.

Meqë nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime në mënyrë unanime të gjithë anëtarët e KPF-së e rekomanduan këtë pikë të rendit të ditës për kuvend.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari -** hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës: **6. Propozim Vendim për caktimin e lokacioneve për zbatimin e Aktgjykimit C. nr. 97/86,të datës 06.10.1988.**

**Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Ruzhdi Lestrani** – sot para jush është një aktgjykim i formës së prerë, i cili e ka marrë edhe konfirmimin nga gjykata e apelit për një rast që ju ka njoftuar drejta e pronës të palës, ne si institucion jemi të obliguar me respektuar dhe me zbatuar këtë vendim dhe kemi marrë masat ligjore, të shkojë përmes kuvendit dhe të respektohet ligji, është bërë komisioni për propozimin brenda zonës të cilën ia ka njoftuar gjykata të drejtën e pronës personit në fjalë, tri lokacioneve në Qikatovë të Re ashtu siç e kërkon ligji.

**Arbër Halilaj,** e shikova arsyetimin, dhe pse nuk mundet aktgjykimi i pronës së prerë të zbatohet në parcelën që saktësisht është e cekur 118/0 mirëpo e kam shqyrtuar këtë rast me palën dhe me avokatin e palës, unë propozoj që kjo pikë e rendit të ditës me u shty dhe me pas kohë që me u informua më hollësisht për këtë, derisa pala shprehet i pakënaqur me këtë zgjidhje. Mendoj që është një çështje e ndejshme vetëm ta hedhim në votime këto tri pronat e propozuara. Kërkoj sqarim pas këtij propozimi vendimi se a keni komunikuar me palën që e ka fituar të drejtën pronësore, edhe a janë tri pronat e propozuara në komasacion?

**Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Ruzhdi Lestrani** – e drejta e pronës të këtyre ju ka njoftuar jo në komasacion, e drejta e pronës ju ka njoftuar jashtë komasacionit, por prona e tij që ju ka njoftuar drejta është futur në komasacion për këtë arsyeje je i obliguar me zbatuar ligjin dhe me i caktuar tri lokacione, në pamundësi me ia dhënë pronën që ia ka dhënë të drejtën gjykata për arsyeje se komisioni i komunës e ka futur atë pronë në komasacion mirëpo pala e ka fituar të drejtën jashtë komasacionit, për këtë arsyeje caktohen tri lokacione me vlerën e tregut të njëjtes brenda zonës kadastrale me tri propozime, janë procedura ligjore që duhet të zbatohet ligji, sa i përket vendimi që merret në kuvend ky shkon për ligjshmëri pranë organeve kompetente nëse atëherë është e jashtëligjshme ministria e kthen jashtëligjshëm.

**Azemine Gjoka**, pse është e pamundur me iu dhënë prona me komasacion atij personi i cili është e njohur prona e tij, pse nuk i lejohet me e marrë me pronën me komasacion.

**Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Ruzhdi Lestrani** - ajo pjesë e parcelës që ia ka njoft gjykata është fut ne komasacion, tash ajo parcelë kane nderuar kufijtë e parcelës ka ndërruar edhe forma, tani ajo parcelë i takon dikujt tjetër.

**Hamit Haxhiu**, a jemi brenda afatit ligjor nëse kjo pikë shtyhet në mbledhjen e ardhshme për Komitetin për Politikë dhe Financa, ta shikojmë më hollësisht këtë çështje?

**Drejtori për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Ruzhdi Lestrani** - çdo vonesë që bëhet është e paarsyeshme, lënda është e kompletuar, është e formës të prerë është e paarsyeshme me e vonuar, ne jemi tani brenda afatit ligjor.

**Florentina Elezi**- edhe unë kërkoj me u shty kjo pike e rendit të ditës për seancën radhës.

Pas diskutimeve kryesuesi hodhi në votim këtë pikë të rendit të ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: 01 votë (**Për**), 06 vota (**kundër**), abstenim nuk pati. Kjo pikë e rendit të ditës u propozua nga anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa të shtyhet për një seancë tjetër të radhës.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari** - hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës: **7. Të ndryshme**

**Florentina Elezi**, kërkoj që për mbledhjen e rregullt të Kuvendit Komunal me raportu për ndotjen e lumit "Drenica"

**Arbër Halilaj**, për hir të transparencës gjitha kërkesat që i parashtrojmë tek të ndryshmet me i ngrit në kuvend, meqë merr pjesë i gjithë ekzekutivi dhe marrim përgjigje.

**Hamit Haxhiu**, kërkoj që të raportoj Komiteti për Komunitete dhe kthim në seancës e radhës ne kuvend sepse nuk ka raportuar i vetmi komitet.

**Kryesuesi i Kuvendit Komunal Milaim Hajdari**, meqë nuk pati diskutime te tjera kryesuesi e konsideroj të mbyllur takimin.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 11:50 min.

Procesmbajtëse:



**Liridona Fejza-Ajazi**



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



**Milaim Hajdari**